



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 7, datë 22.04.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin prill, që zhvillohet në sallën e Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu”

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:23

Data e mbajtjes së mbledhjes : 22.04.2022

Mbajtja e mbledhjes : Qendra Kulturore “Aleksandër Moisiu”

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare !

Të nderuar të pranishëm !

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për muajin prill të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë. I gjithë dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga Sekretarja e Këshillit.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent...ok.....deri tek.... Morena Boja....prezent.....

Kryetar ke 28 këshilltarë në sallë.

(p.s. Hyri me vonesë dhe votoi F.Qoshi dhe A.Ramohitaj në pikën 3 dhe 4 të R.D).

Ani Dyrmishi : Faleminderit !

Vazhdojmë mbledhjen meqë kuorumi është i pranishëm.

Sot për rendin e ditës kemi për të shqyrtuar 4 pika .

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË PAGESËS SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2022, NGA DATA 20 PRILL 2022 NË DATËN 31 MAJ 2022 PËR SHKAK TË RRRITJES SË KOSTOVE TË KARBURANTIT DHE SHPENZIMEVE TË TJERA
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DHJETË TË 16 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL
Shtesa 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.32, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA “LURA”, PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA “AHMET DAKLI”, PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” DUKE PËRFSHIRË Z. ASTRIT DERVISHI
Shtesa 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.32, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA “LURA”, PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA “AHMET DAKLI”, PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” DUKE PËRFSHIRË Z. MARLIN SHKODRA

Kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?....

....(*Morena Boja ngre dorën*)...

Po .

Morena Boja : Përshëndetje të gjithëve!

Unë kisha një koment përsa i përket pikës 3 dhe 4 të rendit të ditës.

Pasi analizova relacionet përkatëse, patjetër që dua të theksoj se jam shumë dakort me kërkesat e qytetarëve, pra qytetarët mund të bëjnë çfarëdo lloj kërkesë dhe ankese, por duke marrë në analizë relacionin dhe duke marrë në analizë raste të mëparshme nuk mendoj se ka një bazë ligjore mbi miratimin dhe përfitimin në këtë rast.

Unë nuk jam jurist kështu që do të doja një shpjegim nga komisioni përkatës, por dhe nga juristët që: A ka një bazë ligjore pse duhet miratuar pika 3 e rendit të ditës për rrjedhoj dhe pika 4? Sepse tek paragrafi fundit në lexoni relacionin është lënë në dorë të Këshillit të vendosë ose jo pro ose kundra këtyre pikave.

Pra mund të themi se dhe komisioni që ka hartuar këtë relacion e ka hequr disi përgjegjësinë nga vetja për bazën ligjore të miratimit të këtyre pikave, sepse ka raste pa fund kur kanë qënë persona brënda të njëjtës certifikatë familjare, por me certifikata pronësie të ndryshme dhe nuk janë përfshirë në fondet të përfitimit të bonuseve të tërmetit. Faleminderit. Nuk e di nëse isha e qartë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Boja .

Pra Ju propozoni që të hiqen nga rendi ditës pika 3 dhe 4, me pak fjalë. Sepse ky koment duhet të bëhet në shqyrtimin e pikës.

Morena Boja : Unë nuk propozoj heqjen. Por dua një shpjegim ligjor se pse këto 2 pika duhen miratuar, sepse me aq sa kam analizuar dhe pika të tjera të ngjashme bie në kundërshtim, pra “Ne” favorizojmë këto 2 persona, siç e theksova unë nuk i njoh dhe nuk kam asgjë personale .

Ani Dyrmishi : Të kuptova shumë qartë.

Morena Boja: Thjesht duhet të miratohen dhe raste të tjera që kanë po të njëjtën logjikë dhe mos të bëhen analiza preferenciale.

Ani Dyrmishi : Të kuptova shumë qartë, por jemi për kalimin për shqyrtim për rendin e ditës. Pastaj kur të vij pjesa e komentit ligjor për pikën 3 dhe 4 mund të shprehesh përse i përket pikave.

Në parim jeni dakort të kalojnë 4 pikat për shqyrtim në Këshill? Kjo ishte ideja për procedurë.

Kush është pro të kalojnë 4 pikat ?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet rendi ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës parë**, i japim fjalën për projektvendimin e pikës parë Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Faleminderit Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

I japim fjalën Komisionit Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj : Faleminderit.

Edhe Komisioni ynë vendosi me të gjitha votat, pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Atëherë ka ndonjë koment përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, nga ana e këshilltarëve të tjerë? Atëherë komente nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 28 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 2 të rendit të ditës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar.

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me pikën 2 dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Faleminderit Kryetar.

Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë ndonjë koment nga ana e këshilltarëve përsa i përket pikës 2, kemi ?

Nuk ka, atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 28 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 3**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim pikën 3 “Për ndryshimin e aneksit nr.1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.32, datë 26.03.2021”, propozon për ta kaluar me shumicë votash pikën 3. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar.

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike me shumicë votash propozon miratimin e pikës 3. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj.Velçani.

Etleva Velçani : Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 3 ?

Po .

Morena Boja: Tani s'është nevojshme që të përsërisë prap ato që thashë. Po doja dikë nga Komisioni Ligjor të më sqaroj pak se pse "Ne" duhet ta miratojmë në Këshill Bashkiak duke qënë se në paragrafin e fundit të relacionit na lihet "Ne" në analizë, pra nuk ka një bazë ligjore që e mbështet miratimin e këtij projektvendimi. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Atëherë Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike kush mund të na argumentoj diçka përsa i përket pikës 3 lidhur me komentet që kishte zonja Boja?

Znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni ynë për pikën 3 dhe 4 për znj.Boja dhe gjithë Këshilltarët e tjerë do të hartojmë një relacion me gjithë komisionet dhe do jua servirim me email të gjithëve arsyet pse duhet të kaloj 3-shi dhe 4-ra.

Morena Boja: Po "Ne" duhet ta votojmë tani jo më pas.

Ani Dyrmishi : Atëherë znj.Budini kërkon fjalën.

Etleva Budini : Jo në formë replike, por po i drejtohem Morenës më shumë, sepse është një shqetësim që e kam pas dhe unë, por dhe shumë shpesh kam shkuar në derën e Zyrës së Rindërtimit dhe të Kryetares së Bashkisë.

Në dijenin time ka raste siç thoni Ju, por janë bërë ankesë dhe janë në shqyrtim e sipër, pra shqyrtimet nuk kanë mbaruar. Ajo që kam kuptuar unë dhe ajo që është shumë e qartë për mua dhe që është dëshira ime është që do të doja që të gjithë qytetarët e dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntorit të fitojnë përsëri banesat e tyre, apartamentet e tyre, siç kanë qënë në këtë datë të tmerrshme të tërmetit. Ky është interesi im si këshilltare dhe si përfaqësuese e lagjes më të dëmtuar mendoj unë, që është lagja 17. Kështu që këtë gjë e kam vënë re dhe unë dhe në Komisionin e Strehimit e kam komentuar, pavarësisht se kam votuar pro patjetër, sepse votoj pro që çdo qytetar i dëmtuar duhet të marrë banesën e vet pavarësisht nga problemet që kanë, sepse për fat të keq "Ne" shqiptarët nuk kemi kulturë prone dhe kemi bërë dhe gabime të tilla. Ka

gabime të ndryshme nga ata qytetarë që kanë qënë pronar, por për fat ka dhe shumë mundësi ka shumë institucione që mund të merren materiale dhe shkresa që vërtetohet që kanë qënë në pronësi se kanë një historik pronësi. Çdo apartament që është dëmtuar, çdo pallat që është dëmtuar ka një histori prone kështu që thjesht ngelet që këto do trajtohen.

Unë kam gjetur bashkëpunim dhe kam bashkëpunuar dhe me Kryetaren e Bashkisë për disa raste në veçanti dhe jemi mirëkuptuar, janë në trajtim e sipër.

Ka raste që nuk kanë marrë dhe përgjigje jo, pavarësisht problemeve të mëdhaja që kanë, sepse ka raste që në hipotekë është marrë materiali për datën 26 dhe ka shumë nga ato që banojnë aty pra vërtetohet dhe nga njësia që banojnë, por që nga ASHK nuk ka ardhur përgjigje pozitive që janë pronar të këtij apartamenti, pra ka probleme të mëdha. Janë në trajtim në dijenin time.

Unë disa raste të veçanta i kam ndjekur dhe po i ndjek personalisht. Kështu që mendoj që në rastin që është përgjigje pozitive, pra në rastin që këto dy banorë sidomos, se fakti që jam e prekur personalisht pasi jam anëtare e këshillit e propozuar sepse aty e kam aktivitetin tim në lagjen 17, që është një nga lagjet e theksoj dhe njëherë më të prekura. Kështu që interesi im si anëtare e Këshillit Bashkiak dhe si përfaqësuese e atij komuniteti është që këto banorë të përfitojnë banesën aq më tepër kur objekti rindërtohet po në të njëjtën sipërfaqe toke, se konceptojnë se si mund të humbet prona pavarësisht nga justifikimet që përmenda.

Morena Boja : Atëherë dëgjo, unë e përmenda pak më parë që kërkesa është shumë e drejtë . Logjikisht unë them po, duhet t'i miratohet, por duke qënë se ka shumë raste të tjera që nuk janë miratuar dhe vazhdojnë e zvarriten nëpër zyrat e rindërtimit, atëherë pse paska një bazë ligjore pro miratimit për këto qytetar, që tani më bën të mendoj që është përzgjedhje selektive dhe nuk paska një bazë ligjore për qytetar të tjerë, që kanë po të njëjtën problematik dhe në rastin më të keq kanë marrë përgjigje jo ose s'kanë marrë Akoma përgjigje, kështu që duhet t'i rrinë te dera zyrës për të marrë një përgjigje, në këtë kontekst e kisha.

Pra, nëse ka një bazë ligjore ajo duhet të shpjegohet dhe duhet të aplikohet tek të gjithë qytetarët e tjerë që janë në pritje dhe nuk mund të presin pa fund.

Etleva Budini : Po pra prandaj janë 2 -3 raste që duhet...

Ani Dyrmishi : Etleva, të lutem.

Faleminderit Morena.

Fjalën e ka Kryetarja.

Emiriana Sako : Pavarësisht se pyetja ishte për komisionin, po jap një sqarim për aq sa i takon bashkisë pastaj këtu janë dhe jurist të Bashkisë Durrës, që mund të japin sqarime konkrete për rast specifik.

“Ne” kemi hyrë në vitin e tretë pas tërmetit të 2019-s dhe në këto dy vite kemi pas prioritetin nr.1 shqyrtimin e programit të rindërtimit, miratimin e listave në programe të ndryshme.Dua të theksoj se ka qënë një spektër shumë i madh pune. Ka pasur një intesitet të madh pune për të cilin përgjithësisht institucionet publike nuk ishin të përgatitura, pra në sensin që volumi i punës ka qënë i jashtëzakondshëm. “Ne” kemi arritur brenda kësaj periudhe kohe, pra të realizojmë një volum të jashtëzakondshëm të kontratave të lidhura dhe familjeve përfituese. Pra kanë përfituar

mbi 15 mijë familje grantet, 6000 bonuset e qerasë, janë përfunduar mbi 260 banesa, janë përfunduar 16 shkolla dhe kjo është një dinamik e jashtëzakondshme volumi pune.

Nga ana tjetër ky program, faktikisht po ndërtohet një qytet i ri, nuk mund të themi që mbaron sot apo mbaron për 6 muaj, sepse është një program, i cili mbart me vete dhe ankesa e problematika të mëdha, të cilat vijnë si pasojë e statusit ku ka qënë familja, dokumentacioni që ka shoqëruar familjen, çertifikatat e pronësisë, çertifikatat familjare e të tjera me radhë. Pikërisht për këto arsye “Ne” rast pas rasti, pra që nga dhjetori 2019-s po them e deri tani nuk kemi asnjë mbledhje të Këshillit Bashkiak ku nuk dorëzojmë materiale për programin e rindërtimit dhe instrumenti i miratimit në Këshill është një instrument që parashikon Akti Normativ nr.9, është një mbështetje e domosdoshme për bashkinë e Durrësit, për qytetarët e Durrësit Dhe “Ne” fatmirësisht kemi pasur mbështetjen maksimale nga ana e gjithë anëtarëve të Këshillit Bashkiak, në tërësi të të gjithë këtij institucioni si të thuash, përse i takon shpejtësisë në veprim dhe t’i përgjigjeshim sa më shpejt të gjithë qytetarëve të Durrësit.

Ju thonë që ka raste që sorollaten, po ju them që unë e kam prioritet rindërtimin dhe të jap përgjigje për rastet. Sigurisht për rastet që janë në vitin e 3-të pa marrë zgjidhje do të thotë që kanë problem në dokumentacion, ka një pasaktësi në mënyrën se si i kanë pas dokumentat e pronësisë, çertifikatat familjare e të tjera me radhë. Qëllimi ynë është që t’i japim përgjigje të gjithë qytetarëve, pse jo të gjithë ata që kanë pasur banesën të kenë mundësi ta marrin. Ka raste që nuk është e mundur, sepse ligji duhet zbatuar patjetër dhe në përgjigje të kësaj vjen dhe nevoja për miratim nga ana e Këshillit Bashkiak.

Këshilli ka marrë dhe që iniciativa të shqyrtoj vetë dosje që bashkia i ka skualifikuar dhe mendoj që mund t’i keni ende në shqyrtim ose do të ktheni një përgjigje se s’do t’i merrni në shqyrtim etj...Sepse “Ne” kemi, domethënë Akti Normativ na kufizon në vendimmarrjen si institucion, ndërsa Këshilli Bashkiak është një institucion që më në makro mund të shikoj problematika, mund të shikoj më në përgjithësi problematikat duke pasur vullnetin e mirë që të gjithë banorët të marrin banesat e tyre.

Unë tani nëse Ju keni nevojë për sqarim për rastin specifik këtu kemi dhe pjesë të stafit të bashkisë, pastaj sigurisht gjithësecili prej jush ka të drejtën e votës dhe ose ta miratoj ose mos ta miratoj këre vendim të propozuar nga ana bashkisë së Durrësit. Faleminderit .

Morena Boja : Ok, faleminderit. Dhe një pyetje kisha unë meqë u përgjigjët Ju.

A ka një procedurë për Zyrën e Rindërtimit dhe sa kohë i duhet për të shqyrtuar një dosje?

Se shpesh përgjigja që marrin qytetarët është : “Prit sa të bëhen disa bashkë”.

Pse duhet të presin të bëhen disa bashkë?

Emiriana Sako : Përgjigja që “Prit sa të bëhen disa bashkë” nuk është një përgjigje që...

Morena Boja : Është një përgjigje e dhënë nga Zyra e Rindërtimit.

Emiriana Sako : Është një përgjigje, që nuk është në bazën ligjore. Pra nuk japim përgjigje të tilla. “Ne” jemi të ndërvaruar..

Morena Boja : Pikërisht se nuk është ligjore ato duhet t’i trajtojnë çështjet rast pas rasti.

Emiriana Sako : Morena mund të flas, meqenëse pyete, ta mbaroj përgjigjen unë, pastaj vazhdojmë me replikat.

Morena Boja : Po, faleminderit.

Emiriana Sako : Pra, vendimi nuk është vetëm i bashkisë së Durrësit, por ndërveprojmë me institucione të tjera, të cilave nuk ja kushtëzojmë dot vendimmarrjen, për kohën që i duhet për shqyrtim e të tjera me radhë. Siç është rasti i Institutit të Ndërtimit, që e kemi institucion kyç për të marrë vendimet “Ne” si Bashki e dhe më tej Këshilli Bashkiak. Institucioni ASHK e Durrësit që ka problematikë të vetën për të zgjidhur sepse është transferuar, ka një strukturë e cila është në analizë e sipër e tjera me radhë dhe këto element bëjnë që “Ne” të jeni gjithmonë në pritje për të plotësuar dosje të caktuara, të cilat vinë në Këshill.

Sigurisht që nëse do të thonim që procesi ka mbaruar do të kishim bërë miratimet në janar të 2020-s për gjithë programin e rindërtimit dhe nuk do kishte nevojë as për diskutime e as për të folur në vitin e 3-të për këtë program, por ndodh që qytetarët nuk kanë dokumentacionin e duhur, nuk tregojnë dot me dokument që posedojnë një pronë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Kryetare.

Nuk e di nëse nga administrata kishte për të shtuar

Alneida Roshi : Të lutem a mundem ta sqaroj pak për pikën 3, meqenëse ma kërkoi rastin specifik .

Ani Dyrmishi : Po, zonja Roshi.

Alneida Roshi : Bëhet fjalë për Astrit Dervishi për t'i thënë dhe njëherë znj.Boja çfarë ka ndodhur pasi trajtohen të gjithë në mënyrë të barabartë. Z.Dervishi është skualifikuar herën e parë dhe i është kërkuar me anë të një ankese drejtuar bashkisë ku ka kërkuar për të përfituar apartamentin e tij ku para se të ndodhte tërmeti ai ja ka dhuruar të ëmës. E ëma ka ndërruar jetë përpara tërmetit dhe ai e ka përfituar këtë shtëpi përsëri me aktin e çeljes së trashëgimisë.

Ai ka rezultuar pronar dhe të një apartamenti tjetër ku me bazë të certifikatës familjare duke qënë se kanë qënë më shumë se 6 persona në 30 m², që është shtëpia e plazhit që i takon shumë pak për frymë që nuk ka kapacitet për të jetuar dhe kjo gjë ka ndodhur duke sjellë dokumenta shtesë kontratën e dhurimit e më pas çeljen e trashëgimisë, që ka ndryshuar dhe njëherë faktin për ta bërë përfitues z.Astrit Dervishi për pikën 3.

Shtimi i dokumentave siç janë kontrata, edhe ka vërtetuar që ka qënë e dhuruar e më pas çelja e trashëgimisë ka ndryshuar faktet.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Roshi.

Nuk e di nëse administrata ka për të shtuar diçka.

Vjola Rutja : Përshëndetje !

Jam Vjola nga Drejtoria e Rindërtimit. Nuk kam gjë për të shtuar nga çfarë tha Kryetarja, vetëm se punojmë dhe vetëm punojmë. Dhe nuk është mirë që askush nga "Ne" ta hedhi poshtë punën 3 vjeçare pothuajse kemi qënë ditë e natë në punë. Nuk është e drejtë të thuhet që nuk keni marrë një përgjigje të tillë nga Bashkia Durrës ose nga Rindërtimi, sepse ka procedura specifike. Dhe në procedura specifike do të hym me emra konkret dhe të japim një përgjigje konkrete. Nëse është pjesë e programit 1-sh,3-sh, pra Ds1- Ds3 normalisht duhet të bëhet një listë për të kaluar, nëse jo, ke procesi i rindërtimit në të njëjtin vënd të pallatit jemi duke punuar për 6 pallate aktualisht për PDyV dhe normalisht duhet t'i nxjerrim të gjithë përfituesit dhe t'i shqyrtojmë të gjithë njëherazi. Kaq kisha.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Atëherë mbas gjithë komenteve dhe sqarimeve që u dhanë nuk e di nëse ka ndonjë koment tjetër nga këshilltarët e tjerë?

Atëherë nuk ka.

Dua të shtoj diçka dhe unë përsa i përket vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak. Gjithsekush ka një votë unanime që voton për veten e tij dhe gjithë procesi i vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak ka një rrugë ankimi administrativ që ndiqet sipas ligjeve në fuqi dhe prefektura që jep ligjshmërinë e vendimeve dhe në Gjykata Administrative nëse dikush apo ndonjë palë e interesuar ka të drejtën e ankimeve dhe kundërshimeve të çdo vendimi që merret nga ana jonë.

Atëherë përsa i përket pikës 3 kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Dorina Milja : Kryetar ke dhe 2 këshilltarë që janë ulur në sallë.

Ani Dyrmishi : Atëherë ok.

Kundra?...Nuk ka.

Abstenim ?

Atëherë 2 apstenim, 28 pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 4**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim pikën 4 me shumicë votash propozon për ta kaluar. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar.

Edhe për pikën 4 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani : Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës është dakort me kalimin në votim me shumicë votash. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Atëherë ka komente përsa i përket pikës 4 të rendit të ditës nga ana e këshilltarëve ?

Nuk kemi, atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim ?

Atëherë 2 apstenim, 28 pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

Duke ju njoftuar për mbledhjen e radhës nga ana e Sekretares së Këshillit Bashkiak për sot mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ju faleminderit të gjithëve për pjesmarrjen.

Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 10(dhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :	ANI DYRMISHI
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :	ELIO JANI
Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :	ETLEVA VELÇANI